



РЕПУБЛИКА Е КОСОВЕС РЕПУБЛИКА NОСОВА  
REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVA  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRQJITSHME  
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. 11-229  
Br.

Data 15.03.2021  
Datum

OBILIQ-OBILIĆ



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo- Republic of Kosova  
Qeveria - Vlada - Government

Komuna Obiliq - Opštine Obilić - Municipality Obiliq

## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 11 dhe 13 të Ligjit Për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 datë 4 Qershor 2008, nenit 4 dhe nenit 10 të Ligjit Nr. 03/L- 139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të dt. 28 tetor 2010 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.91), të dispozitave të nenit 83 të Ligjit të Procedurës Administrative Nr.05/L-031 datë 25 Maj 2016, nenit 73.1 të Statutit të Komunës Nr.I-34 të dt. 25.04.2016 , Vendimit të Kuvendit të Komunës së Obiliqit Nr. I-198 të dt.25.11.2019 për Shpalljen me Interes të Përgjithshëm Publik , Kryetari i Komunës si Organ Shpronësues merr këtë:

## VENDIM PRELIMINAR

### Neni 1

**MIRATOHET** shpronësimi i Njesisë Kadastrale në Zonën Kadastrale në Plemetin Komuna Obiliq për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik realizimi i projektit kapital dhe shumë të rëndësishëm i cili lidh fshatrat e Qyqavicës përmes Plemetinit me fshatin Milloshevë, pra bëhet fjalë për rrugën "Hoxhë Ali Qerkezi " Milloshevë sipas Vendimit të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Obiliqit Nr. I-198 të dt.25.11.2019 si në vijim :

Njësia Kadastrale gjenden në zk.Plemetin Komuna Obiliq dhe atë si në vijim:

- Njësia Kadastrale P-72602052-00784-2 , Lloji i shfrytëzimit të parcelës: Bujqësore; Shfrytëzimi aktual i parcelës : Ara ; Kualiteti i Klasës:Arë e kl.5 ; Sipërfaqja :2354 m<sup>2</sup> ; Vendbanimi – Adresa:Utrina Utrina , e evidentuar në Certifikatë në emër të Hyseni Avni (Mehdi) Pjesa e Pronës 1/1 , nga Plemetini K.Obiliq .

### Neni 2

Brenda 5 ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi,do të njoftohet me Vendimin Preliminar pronari i kësaj Njësie Kadastrale e cila do të shpronësohet.

### Neni 3

Brenda 10 ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi,Vendimi Preliminar do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë

### Neni 4

Kundër këtij Vendimi Preliminar apo cilëso pjesë të tij brenda tridhjetë ( 30 ) ditëve pas hyrjes në fuqi të tij, ka të drejtë të paraqesë ankesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë çdo Person i cili është Pronar ose Zotrues i Interesit në pronën e prekur nga Vendimi Preliminar, dhe i cili ka arsye të mira për të besuar se ky Vendim është në kundërshtim me një ose më shumë kushte të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 4, në përputhje me nenin 35 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të dt. 28 tetor 2010 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.91) .

**Neni 5**

Për Zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit , Drejtoria për Planifikim Urban , Pronë dhe Kadastër , Drejtoria e Financave

**Neni 6**

Vendimi hynë në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Vendimi t'i dorëzohet :**

- DPUKP-së
- DEFZH;
- Pronarit dhe
- Arhivës së Komunës



**Kryetari i Komunës**

*Xhafer Gashi*  
\_\_\_\_\_  
**Xhafer Gashi**